



DËGJIMET BUXHETORE PËR BUXHETIN E VITIT 2026 DHE DY VITEVE PASUESE 2027 & 2028

KOMUNA GJAKOVË DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Sektori i Buxhetit Komunal në përputhje me Ligjin e Menaxhimit të Financave Publike, Ligjin për Buxhet të Republikës së Kosovës dhe Qarkores Buxhetore 2026/01,02 të pranuar nga Ministria e Financave, me datën 22.08.2025 ka organizuar dëgjimin Buxhetore me qytetarët e komunës për Planifikimin e buxhetit 2026 - 2028.

Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa – Durim Halilaj morri fjalën në këtë dëgjim ku se pari njoftoj qe jemi ne ciklin dëgjimeve buxhetore dhe përmbyllës për trajtimin e buxhetit komunal dhe që është mbajtur ne rajonet e planifikuara po ashtu i njoftoj paraprakisht për pranimin e Qarkores së dytë buxhetore nga MFPT-ja.

Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa – Durim Halilaj prezantoi draft buxhetin e paraparë për Komunën e Gjakovës për vitin 2026 që është 42,393,244.00 €. Ne kategorinë e pagave parashihen të shpenzohen 21,817,301.00€ (ku bëjnë pjesë administrata komunale ajo e arsimit, qkmf-ja, zjarrëfiksati etj) Kategoria Mallra dhe Shërbime vlera totale është 4,360,000,00€ (në këtë kategori ekonomike mbulohen mirëmbajtja e ndriçimit publik, mirëmb. e parqeve, furnizimi me ilaçe ne QKMF dhe obligime tjera në bazë të kontratave që janë të publikuara edhe ne Ueb faqen e Komunës sonë) tek kategoria e shpenzimeve komunale (ne këtë kategori mbulohen komunalitet siç janë rryma, uji furnizimi me ngrohje, mbeturinat) kategoria e subvencioneve ka rritje në të gjitha nënkategoritë tjera krahasuar me vitin paraprak këtu planifikohen të shpenzohen 1,602.000.00€. Rritje më të theksuar ka tek dy drejtori ajo Bujqësisë dhe e Zhvillimit Ekonomik (grandet që jepen qofte për Start Up bizneset apo për bizneset aktualë), Kultura Shëndetësia, arsmi. Kategoria e shpenzimeve Kapitale parashihen të jenë 13,603,943.00€ përveq projekteve madhore që janë të përfshira presim edhe ide të reja nga këto dëgjime në mënyrë që ky Buxhet të jetë gjithëpërfshirës bashku me asamblistët presim më 30 shtator që ky draft Buxhet të miratohet.

Përveç Drejtorit të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa të pranishëm ishin edhe Z. Ardian Gjini – Kryetar i Komunës i cili ndër tjerash që dëgjimet buxhetore janë të mirëseardhura për planifikimin e buxhetit sa më të drejtë. I falënderoi qytetarët e pranishëm për interesimin dhe kohën për ti ndjekur këto dëgjime po ashtu ai kërkoi nga ata që ky numër i pjesëmarrësve të jetë në vazhdimësi edhe me i madh. Poashtu ai ofroi përgjigje për secilën kërkesë të pjesëmarrësve si në vijim:

Ardian Gjini – Kryetari i Komunës Si koncept deri ne keto momente vetem ne fshatra jane bere afro 600km rruge te reja kjo tregon qe vazhdimisht kemi punuar ne keto aspekte dhe kemi vendos prioritete (problemet me te theksuara) gjate realizimit te ketyre projekteve. Sikur ne qytet qe e kemi pasur te domosdoshme rregullimin e Lumit Krena me prioritet per shkak se gjitha kanalizimet jane derdhur aty andaj edhe keshtu kemi vepruar ne fshatra me te njejtin logjike. Do te vazhdojne punimet ne Lumin LLukac sic u cek nga nje banore ketu. Ajo cka eshte relevante per Komunen tone eshte qe jemi duke bere stratetigjizime. Ashtu sikur kemi punuar per hapsirat publike Parku i qytetit qe tashme na siguron te hyra

per ne gje qe ne te kaluaren nuk kemi pasur.Ne qe po provojme te bejme eshte te balancojme te pergjithshmen me individualen.Kerkesat tuaja jane legjitime dhe jemi duke arrit ti perfundojme te gjitha rruget,shumecka qe kerkuat ju ndodh qe vetem eshte e kontraktuar kompania nga ana jone.Qasja ne rruget e ndryshme lindin probleme per shpronese por eshte e detyrueshme nga ana jone sado kerkon kohe per kryerjen e ketyre rrugeve.Tek pjesa e kerkeses per shkolle jam ne detaje i informuar do te kete zgjidhje nuk eshte kosto e madhe.Qeshtja e rrenimit te objekteve eshte problem ligjor sepse jane pronesi private dhe nuk kemi te drejte ne si Komune.

Rruga tek pika e zeze eshte e kontraktuar nga niveli qendror nuk kemi te drejte ne te nderhyjme se tashme veq ekziston kontrata valide.Nriqimi publik eshte vonuar me kontrate jo nga ana jone por se ka pas ankesa ne OSHP.Kendi i lojerave e kemi nje marreveshje me nje fondacion privat kemi ngushtica te vogla por qe do te zgjidhen dhe do ti sjellin lodrat shtese.Arte te falenderoj per vleresimin disa pune te vogla nuk kane nevojte per prioritet ashtu sic e kemi bere edhe tek kerkesa per klima qe eshte bere nga nje qytetar tjetere eshte realize po ne te njejten shkolle se ka qene kosto e vogel dhe jane lehtesisht te realizueshme.Rruget publike ne fshatra pothuajse sivej do te kryhen te gjitha.Tema kryesore do te jete kanalizimet neper fshatra sado do te kushtojne ato do te kemi prioritet per ti filluar prej aty ku eshte gjendja me problematike deri tek gjendja me e lehte. Duhet theksuar qe problem i terheqjes se mjeteve nga permbauesit privat nga projektet kapitale ka qene dhe eshte sfide ne vete qe na kane ndikuar shume ne punen tone qe nuk kemi arrit mi permbyll disa projekte.Andaj ju premtoj rruget kanalizimet ndriqimi publik do te kryhen te gjitha.Planifikojme per vitin e ardhshem shume projekte madhore andaj ju inkurajoj qe te jeni qytetar aktiv ne Komunen tone sikur edhe sot qe e keni deshmuar kete.Transporti publik qyteti I menqur,liqeni do te jene nje nder projektet qe do ti japin kuptim qytetit tone.Ju falenderoj shume per pjesemarrjen tuaj.

18.08.2025 ora 18:00

Skivjan

Pjesëmarrja: 18

- Metë Hajdaraj - Dobrigje: Rruga që lidh dy fshatrat Dobrigje dhe Firajë. Është në pronë publike e definuar edhe me kadastër. Rreth 1 kilometër gjatësia.

Përgjigje: Kjo rrugë do të futet në buxhet

- Haxhi Dinaj – Skivjan: Kane mbetur 150 metra pa asfaltuar te rruges ne lagjen “Dinaj”

Përgjigje: Rruga e mbetur eshte prone private.

- Fadil Selimaj – Skivjan: Problemi kryesor ne fshatin Skivjan është ujësjellësi. Ka nevojë për regullim të rrjetit. Skivjani gjithashtu ka nevojë edhe për rregullim të kanalizimit dhe impianti i ndërtuar disa vjet më parë duhet të vihet në funksion sa më parë.

Përgjigje: Kanalizimi do të jetë prioritet I qeverisjes në mandatin tjetër, në bashkëfinancim me KRU Gjakova.

18.08.2025 Ora 19:00

Novosellë e Ulët

Pjesëmarrja: 10

- Gjin Leka – Novosellë e ulët: Janë disa rrugiva të mbetura që duhet të asfaltohen.

Përgjigje. Disa rrugica që janë në pronë publike do të jenë pjesë e buxhetit. Ndërsa disa tjera që janë pronë private duhet të presin.

- Kreshnik Tahiri – Janosh: Zgjerimi i ndriqimit si dhe rregullimi i urës – vendosja e anësoreve të urës në rrugën Novosellë – Janosh.
- Mark Mataj – Novosellë e epërme: Kanë mbetur edhe rreth 600 metra kanale të ujitjes. Jemi në pritje të gjerimit të një pjese të ndricimit publik. Në Palabardh ka nevoje për zgjerim të ndriqimit publik dhe disa metra kanale të ujitjes.

19.08.2025 Ora 18:00

Damjan

Pjesëmarrës: 9

- Ali Cenaj – Damjan: Shumica e rrugëve janë përfunduar. Tashmë ka nevojë për riparim të disa rrugëve që janë asfaltuar më herët. Është rruga Damjan - Pnish 1 km, rruga “Mahmut Duraku” 100 metra. Rruga “Jusuf Duraku” aneks etj.

Ka nevojë për zgjerim të ndriqimit public e gjithashtu edhe riparim të ndriqimit ekzistues.

- Ardiana Bunjaku – kanalizimi në lagjen e Shehut në Damjan është në gjendje të rëndë. Situata është edhe më shqetësuese në oborrin e shkollës meqë i tërë oborri mbushet me ujëra të zeza.

Është gjithashtu rruga që e përdorin nxënësit e cila dërgon në shkollë që ka nevoje për rregullim dhe largim të ujërave të zeza. Gjatësia është rreth 400 metra.

- Valon Pnishi: Në lagjen Shehu ka avari të ndriqimit publik. Ka nevoje për rregullim dhe zgjerim.

19.08.2025 Ora 19:00

Rogovë

Pjesëmarrës: 10

- Elhami Shala: Kërkojmë të fillojnë punimet për hyrje – daljet në afërsi të urës së Rogovës.

Trotuaret nga Rogova në drejtim të Urës së Fshajt.

- Agron Shala: Kemi nevojë për trotuare në disa pjesë të fshatit. Gjithashtu problem i madh në Rogovë është edhe mungesa e kanalizimeve.
- Valon Kryeziu: Është problem rruga “Vjosa” e cila ka nevojë për asfaltim.

08.2025 Ora 16:00

Bec

Pjesëmarrja: 15

- Muharrem Musa: Akset rrugore në fshatin Bec, gjithsejtë 3.7 km rruge të projektuara, gjithsejtë 1.4 km rrugë të pa projektuara, Zhdrellë, Sopot 805 metra, Lugbunar 1.6 km, Qerim 520 metra, rehabilitimi i qendrës së fshatit Bec, trotualet, ndriçimi etj
- Faton Alija: Ka nevojë për caktim të lokacionit për varreza.

20.08.2025 Ora 19:00

Cermjan

Pjesëmarrës: 21

- Hysen Brahimaj Jabllanicë: Në jabllanicë mungojnë disa kanale të ujitjes rreth 2 km. Renovimi i një ure e cila është dëmtuar. Kanë mbetur edhe disa rrugë në total rreth 680 metra. Ka nevojë për ndërtimin e një trotuari nga xhamia deri tek objekti i shkollës, sepse kjo është e domosdoshme për sigurinë e fëmijëve.
- Shkelzen Kurhasku Cermian: Rruga 'Xhafer Kurhasku' rreth 400 metra ka nevojë të asfaltohet dhe kërkojmë që të hyjë në buxhet. Është rrugë e nevojshme sepse përdoret nga nxënësit gjatë vajtje ardhjeve në shkollë.
- Besim Kadrija: lagjia Himaj rreth 1.2 kilometra është e pa asfaltuar.
- Dervish Haziri Gërgoc: Janë disa rrugica në Gërgoc dhe Bardhaniq të cilat kanë nevojë të asfaltohen.
- Sulejman Morava Cermian: Projekt i domosdoshëm është impianti i ujërave të Zeza dhe rruga kryesore që e lidhë Cermianin me Rakovinën e cila është dëmtuar dhe është bërë vështirë e kalueshme.
- Rasim Smajlaj Bardhaniq: Një pjesë e rrugës kryesore është pa trotuar. Në këtë rrugë zhvillohet komunikacion me shpejtësi të lartë e në të cilën kalojnë edhe fëmijët e shkollës. Bardhaniqi ka nevojë për një fushë të sporteve.

21.08.2025 Ora 18:00

Molliq

Pjesëmarrës: 10

- Perparim Zymberi Molliq – në fshatin tonë ka nevojë për investim në disa rrugë publike dhe në ndriçim publik i cili ka pësuar avari.
- Valmir Sadiku Botushë – Një rrugë alternative Botushë – Molliq e nevojshme për nxënësit dhe banorët. Gjithashtu edhe rruga e bjeshkës është kërkesë e fshatit.
- Tahir Asllani Brovinë – Fshatrat tanë kanë nevojë për shtim të kanaleve të ujitjes dhe investime në krijimin e kushteve për bujqësi. Gjithashtu edhe kende të lojrave për fëmijë në fshatin Brovinë.

21.08.2025 Ora 19:00

Ponoshec

Pjesëmarrës: 11

- Hysni Ademaj: Në fshatin Ponoshec është shkatërruar penda nga vëshrishmet e fundit. Duhet të bëhet penda e re bashkë edhe me disa metra të lanaleve të ujitjes. Kërkesë e përsëritur është rregullimi i qendrës së fshatit, një projekt tjetër i domosdoshëm për fshatin.

22.08.2025 Ora: 11:00

Lokacioni: Pallati i Kulturës “Asim Vokshi”

Pjesëmarrës: 27

- Palush Nikolla – Kryetar i Keshillit Lokal Dol

Përsëritje të nderuar, po i parashtroj gjitha kërkesat sikur herëve të tjera të disa rrugëve që kanë mbetur pa u kryer rruga e Leqeve për shkak të mungesës së buxhetit, rruga tjetër është tek Luga e Mire ku është bërë pjesa për tek kampi veror afër 130 metra, mundësisht edhe një pjesë të sanimit tek Doli që lidhet me Kushavecin, poashtu edhe rruga “Martirët e Kushavecit”

- Augustin Topalli-Kryetar i Keshillit Lokal Bishtazhin

Përsëritje për të gjithë pjesëmarrësit, në broshurën e prezentuar nga ju e shikova që janë ndarë 100,000.00€. Është rruga Martirët e Kushavecit” janë disa familje në gjendje të mjerushme dhe kemi pasur premtim që kjo rrugë do të fillojë poashtu kemi disa rrugica neper fshat që kërkohen mu ndërtu, poashtu rruga kryesore e fshatit Kushavec që është në gjendje mjaft të mjerueshme dhe është bërë e pakalueshme kemi edhe rrugë të tjera si e fshatit Marmull, Rezina, rruga e Smaqit poashtu në rrugë dytësore nuk ka pas intervenime. Kemi edhe disa probleme tek fshati Fshaj si shkak i daljes nga shtrati i Lumit disa familje nga vërshimet kanë pësuar andaj kërkohet rregullimi i shtratit të Lumit dhe problemeve me ujë. Shpresojme që disa nga kërkesat tona të realizohen.

- Dode Lleshi-Dol

Përsëritje për të gjithë ju, une parashtroj një kërkesë të vogël, dy herë kam bërë kërkesë me shkrim për sanimin e gropave në Dol, prej rrugës së Moglicës deri të shkollës së Dolit janë sanuar prej kësaj shkolle me nuk kemi sanim të gropave, poashtu kërkesa ime është ndricimi publik pasi tani janë shtyllat prej betonit.

- Lulzim Haxhiu- Kryetar i bashkësisë lokale I

Përsëritje për të gjithë në vazhdimësi kam kërku dhe do të vazhdoj të kërkoj ndërtimin e rrugës tek pika e zezë Rezinë Veriore. Kanë fillu ndërtimi i disa rrugëve të tjera mirëpo ka nevojë emergjente edhe të tjerat për tu bërë siq është Muhamet Ukshini, Mujë Zeneli, Rexhep Tafa. Kujdes duhet të kushtohet edhe shtratit të Lumit LLukac(Trakaniq) ku do të përfshihej edhe kanalizimi që i mbledh të gjitha ujërat e zeza të pjesës së Dardanisë ku derdhen në këtë Lum, pra kërkesë është vazhdimi i rregullimit të këtij Lumi. Tek hapsirat publike e kemi tek Shkollës fillore “Zekeria Rexha” që ka nevojë për një rindërtim total që mund të shfrytëzohet edhe nga nxënësit edhe nga banorët për shkak hapësirës së madhe ekziston.

Propozim:Ndertimi i nje lapidarit te bashkesise lokale i ku ne kete pjese kemi pas shume viktime civile? Vlen te ceket te qe jane bere edhe shume pune te mira ne veqanti tek shtrati i Lumit Krena.

- Valon Miftari-Qerim

Problemi tek zona jone eshte qasja hyrje/dalje ne rrugen publike nga shtepite ku banojme, kane qene edhe Inspeksioni per te shikuar gjendjen ne teren, andaj presim qe ky problem te zgjidhet.

- Ergit Qeli-Kryesues per komitete

Pershendetje Kryetar dhe gjithe ju te pranishem, Kryetar kerkoj te di sanimin a do te perfshihet edhe lagjja Shote Galica per shkak se aty banojne edhe pjestarët e komuniteteve, kemi kerkuar edhe rekomandim ne kuader te komitetit pe komunitete poashtu edhe per trotuaret per lagjen “Edit Durham” ka mjaft nxenes te komunitetit tone qe vijojne shkollen a do te perfshihen edhe kjo pjese per trotuare?

- Arjeta Hajdaraga-ushtuese e detyres shkolles fillore “Emin Duraku”

Pershendetje per te gjithe ju, gjithmone shqetesuese per shkollen tone eshte oborri prapa shkolles kerkesa jone eshte qe te ndahet buxhet per mirembajtjen e oborrit, Kompania e pastrimit Cabrati ka konstatu qe eshte pak zone problematike per pastrim njekohsisht shpreh momentin te falenderoj kete kompani qe vullnetarisht na ka ndihmu poashtu edhe Drejtorine per Arsim.

- Gemb Canamusa-Gjakove

Pershendetje, ne rrugen Mithat Frasheri ku banoj gjendet nje objekt i vjeter qe eshte prane rrezimit dhe eshte i rrezikshem per qytetaret,kerkese kam bere prane komisionit te rrezimin e objeteve te vjetra, edhe konsultim prane zyres ligjore kam bere per kete problematike,prane ketij objekti hyjne edhe persona te papergjegjshem qe e rendojne edhe me shume situaten andaj kerkoj qe te ndermerren masa ndaj kesaj qeshtje.

- Ardian Marku- Kryetar i bashkesise lokale Doblibare

Pershendetje per te gjithe, bashkesine lokale kane fillu disa punime por mendoj qe ne vitin 2026 do te kemi edhe me shume. Ndricimi publik eshte njera kerkese qe i mungon ketij fshati jemi te informuar qe veq eshte e kontraktuar kompania andaj mbesim me shprese qe do te rregullohet.

Rruget Zef Gjiododa jane dy rruge te shkurta gjithashtu ne fshatin Berdosane ne rrugen Pjetet Qeli eshte lagjja Marku, poashtu ne rrugen Prenk Karaqi lagjia Dushi po ne te njejten rruge, Doblibare eshte rruga Frank Bardhi rruga kryesore qe lidh tre fshatra jane te demtuara dhe jane rruge te medha ndersa kerkesa ime eshte ndertimi,sanimi i ketyre rrugeve.

- Ramadan Bezera-Gjakove

Pershendetje, pyetja ime eshte specifike lidhet tek dalja per Prishtine aty edhe ku une banoj krijohet kolone e madhe a eshte e kontraktuar nga niveli qendror apo ai lokal?Kerkesa ime e dyte ka te beje me kendin e lodrave tek Drejtoria e Kadastres a shte e mundur te behet shtimi I luhatese tjera se numri I madh I femijeve nuk mjaftojne vetem ato ekzistueset. Rruga “Dashmir Krasniqi”eshte me disa gopa a do te behet rregullimi I tyre. Ju faleminderit.

- Arti Kupa-Gjakove

Pershendetje Kryetar po flas ne cilesine e prindit kerkesa ime e parashtruar para disa viteve eshte realizuar andaj ju falenderoj shume behet fjale per instrumentet e shkolles muzikore per femijet tane, tashme veq i gezojme rezultatet e asaj shkolle.